



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik



Në mbështetje të nenit 58 të Ligjit nr.03/L.-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 73 i Statutit të Komunës së Kaçanikut, si dhe nenit 9 të Rregullorës Nr.04/2017 Mbi Kriteret dhe Standartet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Kryetari i Komunës së Kaçanikut më datë 10.04.2023 merr këtë :

Data 10.05.23		Vendi KASANI
Uj. org.	Numri	Shtojcë
01	105/02-10992	

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE

1. Me këtë vendim, formohet komisioni i ankesave në përbërje prej 3 anëtarëve për vlerësimin e Ankesave kundër Njoftimit Nr. 01-104/02-10516 të datës 04.05.2023 për financimin e projekteve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2023 në përbërje :
 - Jeton Topalli -Kryetar i Komisionit
 - Vedat Dema - Anëtarë
 - Kaltrina Luma - Anëtare
 - Muharrem Ahmetaj - Anëtarë rezervë
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit vlerësues janë të përcaktuara në nenin 21 të Rregullorës Nr. 04/2017 Mbi Kriteret dhe Standartet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset : Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
4. Me këtë vendim njoftohen : Kryetari i Komunës, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, anëtarët e komisionit dhe arkivi i komunës.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Dt. 29.05.2023

81 Nr. 104/02-12814/23

Zyra e Kryetarit

Në bazë të nenit 13.17 të Ligjit nr.03/L-40- Për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit të Buxhetit Nr. 08/L-193 per vitin 2023 , të nenit 61.dhe 73, të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Neni 1.

Me anë të këtij vendimi i lejohet OVL UÇK - Dega ne Kaçanik, të furnizohet me derivate- naftë në sasi prej 100 litra derivate. Ky vendim mirret me qëllim te realizimit te aktiviteteve të përbashketa mes komunes se Kaçanikut dhe Shoqatës së Invalideve te Luftes se Uçk Dega ne Kaçanik gjate vitit 2023.

Neni 2.

Për sasinë e lejuar sipas pikes 1. të këtij vendimi, OVL UÇK mund të furnizohet me derivate të naftës tek operatori ekonomik, i cili ka kontratë të arritur me K.Kaçanik për furnizim me derivate "Bubeari Petrol" dhe pas furnizimit , obligohet që fletdërgesat në ngarkim ti dorëzoj pranë të Drejtorisë së Administratës Komunale (Zyra e Pranimiit të mallrave - faturave) –Kaçanik.

Neni 3.

Me kete vendim njoftohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Financave dhe OVL UÇK - Dega ne Kaçanik.



KOMUNA E KAÇANIKUT
Besim Hazi, Kryetar i komunës